

buletini info

Buletin informativ mujor
Dhjetor, 2022



TAKIM PËRMBYLLËS I IRDK-së ME AKTIVIST DHE MYSAFIR



Deputeti Fridon Lala takon
të rinjë nga komuniteti
Egjiptian e Ashkali



Përurohet parku dhe këndi
i lodrave në lagjën e
komuniteteve në Gjyrkoc



Përkujtohet veprimtari i
IRDK-së, Ramiz Zizaku



TAKIM I KRYESISË SË IRDK-SË ME AKTIVIST

Me datën 29.12.2022, në Gjakovë, në një atmosferë festive, Kryetari i IRDK-së, bashkë me anëtarët e Kryesisë i kanë ftuar në një takim përmbyllës të vitit 2022.

Kryetari Elbert Krasniqi ka bërë një përmbledhje të aktiviteteve të vitit 2022 të realizuara nga angazhimet në Qeverinë e Kosovës dhe në koordinim me institucionet tjera. Ai përmendi



premtimet që kishte bërë IRDK-së në zgjedhjet e fundit parlamentare dhe shkallën e realizimit të tyre. Gjatë këtij viti i kemi realizuar projekte në vlerë prej 1 milion euro të dedikuara për mbështetje të infrastrukturës të komunitetet ku një nder përfituesit më të mëdhenjtë ka qenë komuniteti Egjiptian dhe Ashkali, theksoi kryetari Elbert Krasniqi. Uji i pijes në Fushë Kosovë sivjet nuk është realizuar por është projekt me prioritet të lartë për vitin 2023 dhe implementimi i tij do të jetë i realizueshëm pasi që projekti detal është i hartuar dhe financimi i tij është

siguruar nga Buxheti i Kosovës, vazhdoi Elbert Krasniqi. Ai përmendi edhe mbështetjen për arsimin që po i jep Qeveria e Kosovës për komunitetin tonë duke ndarë bursë për studentet dhe nxënësit e komunitetit Egjiptian.



Deputeti i IRDK-së Fridon Lala ka potencuar angazhimet e IRDK-së, si përfaqësuese politike e komunitetit për t'i dalë në ndihmë komunitetit Egjiptian aty ku paraqitet nevoja dhe atëherë kur ekzistojnë mundësitë. Ai premtoj angazhim në adresimin e nevojave edhe gjatë vitit 2023. Kryetari i IRDK-së Elbert Krasniqi dhe zëvendëskryetari Fridon Lala i falënderuan përzemërsisht të pranishmit për angazhim gjatë vitit 2022. Falënderim të veçantë për mysafirët z.Muhamet Salihu nga Gjermani, Isa Osmani nga Ferzaj, Bashkim Krasniqi me shokët nga Mitrovica dhe të gjithë pjesëmarrësit e kësaj mbrëmje.





NDIHMOMET ME 20,000€ FAMILJA E BEKIM QUKANIT NGA GJAKOVA

Të dielën e datës 19.06.2022, pas mesnatës në rrugën "Yll Morina", në lagjen "Blloku i Ri", një banesë ishte



përfshirë nga zjarri, ku për fat të keq një fëmijë 11 vjeç ka humbur jetën, ndërsa lëndime kanë pësuar një fëmijë tjetër dhe prindi i tyre. Viktima ishte vajza e Bekim Qukanit, pjesëtar i komunitetit Egjiptian, i cili banonte në banesë në Bllokun e Ri.

Bekimi, për mediat kishte rrëfyer për ngjarjen tragjike që i kishte ndodhur familjes së tij:

"Kur e kam pa flakën e kam marrë djalin dhe kam dalë, por vajzën nuk kam pasë shansë. Por edhe djali është i dëmtumë, në trup, në krah", kishte theksua prindi i viktimës, Bekim Qukani.

"Mbas një kohe më ka dal gjumi, vajzën nuk e kam parë se ku ishte prej tymit të madh. Djalin e kam parë në flakë dhe e kam larguar dhe kemi dalë nga banesa. Si ka ardhur deri te zjarri nuk e di".

"Gruaja ka qenë te familja e saj, atë e kam telefonuar nga komshinjtë, dhe më pas ka ardhur. Vajza pas dy muajve ka pasur t'i mbushë 12 vjet. Ka qenë e palëvizshme që nga lindja, si ajo edhe djali. Tani s'kam më shtëpi, vet i treti jam dhe nuk kam ku të shkoj", deklaroi Bekim Qukani menjëherë pas tragjedisë.



Me datën 20.12.2022, deputeti i IRDK-së, Fridon Lala dhe Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, e kanë vizituar Bekim Qukanin dhe i kumtuan lajmin se Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndarë 20.000 euro si ndihmë për të rehabilituar vendbanimin e tij pas fatkeqësisë që i kishte ndodhur në qershor të këtij viti. Në këtë rast, deputeti Lala theksoi: " 20,000€ janë ndarë për familjen e Bekim Qukanit nga Gjakova nga Qeveria e Kosovës, banesa e të cilit kishte marrë flakë, incident në të cilin fatkeqësisht humbi jetën vajza e tij 11 vjeçare, Rrahime Qukani. Kjo shumë do të shërbej për renovimin e vendbanimit për familjen Qukani. Falënderoj Ministrin Elbert Krasniqi për prioritizimin e këtij rasti dhe urojmë që raste të këtilla tragjike të mos na përsëriten."



PËRKUJTOHET VEPRIMTARI I IRDK-së RAMIZ ZIZAKU

Në përjetorin e parë të ndarjes nga jeta, Kryetari i IRDK-së, Elbert Krasniqi, i shoqëruar nga familjar të Ramizit dhe nënkryetari Valmir Rama, anëtarët e Kryesisë Eros Gashi, Lush Çukaj, Mergim Neziraj dhe bashkëpunëtorët tjerë Xhevdet Neziraj, Fazli Stollaj, Ibish Berisha, Xhevat Neziraj, kanë bërë homazhe te varri i Ramiz Zizakut në Pejë.



Kryetari i IRDK-së Elbert Krasniqi theksoi se Ramiz Zizaku ishte shoku ynë, bashkëpunëtori i ngushtë i Kryesisë së IRDK-së, njeriu që na dha shpresë në çdo kohë. Ne Ramizin do ta përkujtojmë gjithmonë dhe do të ndjekim rrugën të cilën e trasoj Ramizi, ka vazhduar kryetari Elbert Krasniqi.

Veprimtari Ramiz Zizaku u nda nga jeta me 4 dhjetor të vitit 2021. Ai mbetet një ndër figurat kryesore të IRDK-së dhe komunitetit Egjiptian/Ashkali i cili bëri shumë përpjekje që të jemi bashkë.



DEPUTETI FRIDON LALA VIZITON FAMILJEN E DËSHMORIT XHEVDET HOTI

Deputeti i IRDK-së në Parlamentin e Kosovës, Fridon lala, me datën 11.12.2022 ishte mysafir në konakun e Shaban Hoti në Shqiponjë - Jabllanicë.

Familja Hoti, janë njëra prej shumë familjeve të komunitetit Egjiptian të cilat ishin pjesë e

pandashme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke kontribuar shumë në luftën tonë për liri dhe pavarësi.

Në mes tjerash, baci Shaban i dha Kosovës dhe djalit, dëshmorin e kombit, Xhevdet Hotin, i cili ishte ushtar i Brigadës 132 - Myrtë Zeneli, dhe ra heroikisht me 8 Shtator 1998.





DEPUTETI FRIDON LALA TAKON BANORËT NË NOVOSELLË DHE LAGJEN ALI IBRA NË GJAKOVË

Deputeti Fridon Lala, me datën 10.12.2022, në fshatin Novosellë, kishte mundësinë të bashkëbisedojë me banorët dhe njoftohet me problemet e brengat e tyre.

Anashkalimi i vendbanimeve të komunitetit Egjiptian nga qeverisjet lokale në projektet infrastrukturore është i paimagjinueshëm, ka konstatuar deputeti Lala pas kësaj vizite.

Deputeti Fridon Lala falenderoj Ramiz Zajaj dhe banorëve për mikpritjen.

Në të njëjtën ditë Fridon Lala ka vizituar lagjen Ali Ibra në Gjakovë. Në këtë takim deputeti Lala ka treguar gatishmëri dhe përkushtim që kjo lagje të jetë e përshtshme dhe të plotësoj kushtet e domosdoshme për jetë normale, në veçanti të ketë ambient të pastër. Qeveria e Republikës së Kosovës është duke implementuar gjatë këtij viti projektin për pastrimin e deponisë transite të qytetit të Gjakovës që gjendet në këtë lagje. Projekti për pastrimin e deponisë në lagjen Ali Ibra do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2023 për të krijuar hapësira të gjelberta në vendin ku kanë pushuar mbeturinat për shumë vite.



Deputeti i IRDK-së Fridon Lala në takim me banorët e fshatit Novosellë të komunës së Gjakovës



Deputeti i IRDK-së Fridon Lala në takim me banorët e lagjës Ali Ibra - Koloni, të komunës së Gjakovës



DEPUTETI FRIDON LALA TAKON NË PARLAMENT TË REJA DHE TË RINJË NGA KOMUNITETET EGJIPTIAN, ASHKALI E ROM

Me datën 14.12.2022, deputeti i IRDK-së në Parlamentin e Kosovës Fridon Lala, në ambientet e Kuvendit të Kosovës, së bashku me Kryetarin e Parlamentit Glauk Konjufca dhe Kryetarin e Grupit të Deputetëve të Rinjë, Agon Batusha kanë pritur një grup të rinjesh nga komunitetet Egjiptian, Ashkali dhe Rom.


Deputeti Fridon Lala mbetet i përkushtuar për të trasuar rrugën për të rinjtë e rejat tona, tek të cilët nuk mungon vullneti dhe potenciali për të qenë pjesë e ndryshimit të mirëqenies së komunitetit të tyre.





70.000 €

GJAKOVË




Kubëzimi i rrugëve lokale për komunitetet minoritare në Skivjen dhe Piskotë dhe Ndërtimi/sanimi i rrugëve me kubëza betoni në lagjet dhe fshatrat ku jetojnë komunitetet në Gjakovë.



OBILIQ

140.000 €



Punimi i kanalizimit dhe Asfaltimi i rrugës në Plementin dhe Rehabilitimi i infrastrukturës fizike te komuniteteve Rom, Ashkali, Egjptian në Plementin



DEÇAN

40.000 €



Asfaltimi i rrugës “Sadrijaj” Gramacel - Deçan



90.000 €



**Muri rrethues në shkollën fillore "Asdreni" dhe "Xhemajl Kada",
Ndërtimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në fshatin Vitomiricë,**



MITROVICË

40.000 €



**Termoizolimi dhe zëvendësimi i dritareve në shkollën fillore
“Bedri Gjinaj”**



LIPJAN

40.000 €



Asfaltimi i rrugëve në Lipjan dhe Hallaq i Vogël



RAHOVEC

40.000 €



Ndërtimi i rrugëve dhe këndit rekreativ në lagjen e komuniteteve



SHTIME

50.000 €



Rregullimi i parkut dhe kendit të lodrave në lagjen e komuniteteve në fshatin Gjyrkoc



ISTOG

50.000 €



Ndërtimi i ndriçimit publik në rrugën 7 Marsi në Gurrakoc, rrugën 24 Qershori në Zallq dhe Asfaltimi i rrugës Sadri Lata në Zallq



FERIZAJ

40.000 €



Asfaltimi i rrugës dhe trotuarit në fshatin Dubravë, Ferizaj



KLINË

40.000 €



Ndërtimi i rrugës dhe infrastrukturës nëntokësore në fshatin Dresnik dhe Shtupel

buletini info

Kontriboni me shkrimet e juaja autentike si:

Opinione

Kulturë

Histori

Shkencë

Dërgoni në email: buletini.info@gmail.com